



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

RAPORT

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

NJËSIA BASHKIAKE NR. 5

Tiranë, Tetor 2015

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil
Bashkia Tiranë
Njësia Administrative nr. 5
(Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë)

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", dhe planit të mbikëqyrjes miratuar me Vendimin nr. 51, datë 26.05.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë", ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Njësinë Bashkiake nr. 5, Tiranë.

Mbikëqyrja u realizua sipas programit të mbikëqyrjes nr. 390/1 prot., datë 26.05.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njoftuar institucionit me shkresën nr. 390/2 prot., datë 26.05.2015 "Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes".

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil dhe zbatimin e tij gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në zbatim të Vendimit nr. 51, datë 26.05.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë", grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga Dorina Nika dhe Stela Ndoka, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspeksionit, Arbana Basha, realizoi përpunimin e të dhënave dhe përgatiti projektraportin "Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë", të cilin ja ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur, me shkresën nr. 390/3 prot., datë 23.09.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Pas kësaj, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 390/7 prot., datë 06.10.2015 "Përgjigje në lidhje me projektraportin", ka kthyer projektraportin e nënshkruar nga Administratori i Njesisë Administrative dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore. Në përmbajtjen e kësaj shkrese institucioni ka vlerësuar konstatimet dhe është shprehur dakord me projektraportin duke shprehur gatishmërinë për zbatimin e rekomandimeve.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dalura në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e

situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit Civil", apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve;
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës;
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësit civil", i ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe institucionit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës, etj.*).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësia përgjegjëse*) gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivin e institucionit, si dhe në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

1. Fillimisht, u realizua një takim me personin e kontaktit, Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, ***** gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit të mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim;
2. U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
3. U verifikuan procedurat e rekrutimit sipas procedurave konkurruese, të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil";

4. U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
5. U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, etj;
6. U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listëpagesat për periudhën shkurt – mars 2014, shkurt – prill 2015, listëprezencat e punonjësve.

Konstatimet e procesit të mbikëqyrjes janë materializuar si anekse më vete të organizuar në formën e tabelave dhe janë pjesë përbërëse e këtij raporti, si më poshtë:

- *Aneksi 1 "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)".*
- *Aneksi 2 "Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 5, Tiranë".*
- *Aneksi 3 "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të cilët ishin punësuar nëpërmjet konkurrimit (data 26.02.2014)".*
- *Historiku i marrëdhënies së punës për punonjësit në Njësinë Bashkiake nr.5, Tiranë.*

Përmbajtja e Projektraportit

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

a) Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në institucion, sipas strukturës aktuale.

Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, ka qenë e organizuar si pjesë e qeverisjes vendore, statusi i të cilës përcaktohej në ligjin nr. 8654, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", aktualisht i shfuqizuar me ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Në nenin 13 të ligjit nr. 8654, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës" përcaktohej se: "organet e njësive bashkiake dhe administrata e tyre përfitojnë të drejta, si ato të bashkive të tjera të vendit, përsa i përket trajtimit të tyre". Gjithashtu, neni 5 dhe 6 i ligjit nr. 8654, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, përcaktonte bashkinë (rrjedhimisht edhe njësitë bashkiake), si njësi të qeverisjes vendore. Për pasojë, në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, përfshihet dhe institucioni i Njesisë Bashkiake nr. 5, Tiranë në përputhje me përcaktimet e nenit 2 të tij, ku parashikohet shprehimisht se "ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore...", i cili tashmë është njësi administrative e Bashkisë Tiranë.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, në Bashkinë e Tiranës funksiononin 11 njësi bashkiake të qeverisjes vendore dhe administrata e tyre organizohej mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë, sipas parashikimeve të nenit 32, shkronja "ç" të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Struktura organizative dhe organigrama e Njesisë Bashkiake nr. 5, Tiranë, është miratuar me Vendimin nr. 18, datë 26.01.2001 të Këshillit Bashkiak Tiranë "Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës", ndryshuar në vijimësi në rend kronologjik me Vendimin nr. 10, datë 21.03.2005 "Mbi disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.01.2001 "Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës", Vendimin nr. 5, datë 05.02.2007 "Për caktimin e njësive bashkiake si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si dhe për një shtesë në numrin e punonjësve në strukturën organizative", Vendimin nr. 20, datë 30.04.2007 "Për kalimin e disa kompetencave njësive bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit", Vendimin nr. 23 datë 09.04.2013 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 17, datë 28.02.2013 "Mbi politikën e decentralizimit të disa kompetencave ligjore pranë organeve të Njësive Bashkiake të Tiranës, si dhe një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 30.04.2007 "Për kalimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit" (i ndryshuar)".

Në përputhje me sa më sipër, struktura organizative e Njesisë Bashkiake nr. 5 të Tiranës, përfshin gjithsej 29 pozicione pune. Rezulton se në institucionin e mbikëqyrur, 15 pozicione pune të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë janë konsideruar pjesë e shërbimit civil, ndërsa 14 pozicionet e tjera trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Në mbështetje të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", shërbimi i gjendjes civile, ushtrohet si funksion i deleguar në organet e qeverisjes vendore. Në përputhje me nenin 62 të këtij ligji dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1299, datë 16.12.2009 "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarqeve", Zyra e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, përfshin 5 pozicione pune nga të cilat, 1 Përgjegjës Zyre dhe 4 Specialistë.

Sa më sipër, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës pranë Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë është 34 (tridhjetë e katër).

Nr.	Pozicione pune	Numri i pozicioneve të punës
1.	Pozicione pune politike	3 (tre)
2.	Pozicione pune të shërbimit civil	17 (pesëmbëdhjetë)
3.	Pozicione pune për punonjës administrativë të rregulluara sipas Kodit të Punës	9 (nëntë)
4.	Pozicione pune në Zyrën e Gjendjes Civile	5 (pesë)
Numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës		34 (tridhjetë e katër)

Duke marrë në konsideratë klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1619, datë 2.7.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këto kategori:

Nr.	Pozicionet e shërbimit civil të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës	Emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës së miratuar	Numri i pozicioneve të punës sipas kategorisë dhe klasës	Klasa
1.	Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues	Përgjegjës sektori	3 pozicione sipas strukturës së miratuar	III - a
		Përgjegjës zyre	1 pozicion sipas strukturës së miratuar	IV - a
			1 pozicion sipas VKM-së nr. 1299, datë 16.12.2009	IV - a
2.	Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialistë	11 pozicione sipas strukturës së miratuar	IV - a (6 pozicione) IV - b (5 pozicione)
			4 pozicione sipas VKM-së nr. 1299, datë 16.12.2009	IV - b
			Pozicione të shërbimit civil gjithsej	

Më konkretisht, pozicionet e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë, pjesë e shërbimit civil, përfshijnë sa më poshtë:

- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese, në të cilën përfshihen **3 (tre)** pozicione pune "Përgjegjës Sektori" dhe **2 (dy)** pozicione pune "Përgjegjës Zyre", dhe më konkretisht pozicionet:
 - Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike;
 - Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore;
 - Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës;
 - Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale;
 - Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, në të cilën përfshihen **15** (pesëmbëdhjetë) pozicione pune, nga të cilat **6** pozicione pune i përkasin pozicionit "Specialist i mesëm" dhe **9** pozicione pune i përkasin pozicionit "Specialist i ulët", dhe më konkretisht pozicionet:
 - 6 pozicione "Specialist i mesëm"
 - Ekonomist
 - Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës
 - Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës
 - Specialist në zyrën e përkrahjes sociale (Administrator social)
 - Jurist
 - Inspektor taksash
 - 9 pozicione "Specialist i ulët"
 - Specialist në zyrën e përkrahjes sociale (Administrator social)
 - Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
 - Specialist i informimit qytetar
 - Inspektor taksash
 - Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës
 - 4 pozicione Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se **80 %** e nëpunësve, pjesë e shërbimit civil pranë këtij institucioni janë femra dhe **20 %** e tyre meshkuj. Moshë mesatare e nëpunësve civilë në këtë institucion është **44 vjeç**, ndërkohë që në pjesën më të madhe të tyre, edukimi arsimor i përket fushës së shkencave sociale dhe ekonomike.

Duke u nisur nga natyra e punës dhe kategorizimi i pagave për pozicionet e renditura më sipër, konstatohet se disa pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive të nëpunësve civilë, në pozicionin "*specialist*", në momentin e mbikëqyrjes në strukturën organizative të institucionit paraqiten me emërtime të tilla si "*jurist*", "*ekonomist*". Këto emërtime në fakt përfaqësojnë profesionin e kërkuar dhe jo emërtimin e pozicionit të punës në përputhje me klasat dhe nivelet e parashikuara në ligj. Nga përmbajtja e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", dhe më konkretisht, të Lidhjes nr. 3 "*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës*", e cila është pjesë e këtij vendimi, rezulton se, emërtimi i pozicioneve të punës të kategorisë ekzekutive, realizohet duke i klasifikuar pozicionet e punës sipas profesioneve, apo sipas grupeve të ngjashme të punës. Pozicione të tilla si, "*Jurist*" apo "*Ekonomist*", "*Specialist urbanist*", "*Specialist infrastrukture*", etj, sipas këtij akti nënligjor, përfshihen në grupin e administrimit të posaçëm, të cilat, në kuptim të ligjit, kërkojnë njohuri të posaçme për realizimin e detyrave funksionale.

Nga ana tjetër, në subjektin e mbikëqyrur, grupi i punës konstaton se **2** pozicione pune nuk janë trajtuar si pjesë e shërbimit civil. Bëhet fjalë për pozicionin e punës me emërtesën "*Arkivist-Protokollist*" dhe pozicionin "*Specialist për tregjet*".

Lidhur me pozicionin e punës "*Arkivist-Protokollist*" sjellim në vëmendjen e njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore se:

Së pari, pozicioni i punës "*Arkivist-Protokollist*" është pjesë e organikës së institucionit dhe është pozicion pune që ka përgjegjësi, në mënyrë specifike për administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të subjektit të kontrolluar. Pra, fokusi i punës së mbajtësit të këtij pozicioni është ruajtja dhe mirëmbajtja e fondit të dokumenteve që krijohen, apo hyjnë në institucion.

Së dytë, brenda strukturës së institucionit, ky pozicion pune është i vendosur në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe raporton tek përgjegjësi i sektorit.

Së tretë, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*" në pikën 9, shkronjat "*a*" dhe "*b*", dhe në pikën 12 kreu III, përcakton:

9. "Pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive klasifikohen sipas natyrës së pozicionit në:
 - a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe;
 - b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.
10. ...
11. ...
12. Grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në Lidhjen 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi."

Më tej, Lidhja nr. 3 "*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/ sipas profesioneve të punës*", në kolonën e parë ka renditur grupet e specialistëve të administratës publike të përfshirë në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil sipas profesioneve. (Kjo lidhje është e

ndërtuar me 6 kolona). Në ndarjen me numër rendor 26, në kolonën e dytë dhe të pestë përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës specialist i arkivave/arkivist, në njësitë vendore në përputhje me legjislacionin përkatës të arkivave.

Sa më sipër, pozicioni i punës “Arkivist-Protokollist”, në varësi të detyrave funksionale që përmbush dhe që duhet të gjejnë pasqyrim në përshkrimin e punës për këtë pozicion, rekomandohet të rishikohet nën prizmin e trajtimit si një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Lidhur me pozicionin e punës “Specialist për tregjet” rezulton se ky funksion i është deleguar njësisë bashkiake nga Bashkia e Tiranës, me vendim të këshillit bashkiak dhe ky pozicion nuk është konsideruar nga institucioni i mbikëqyrur si pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Nga verifikimet rezulton se, Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Tiranës, me Vendimin nr. 51, datë 03.11.2004 “Për delegimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake të qytetit të Tiranës”, ka miratuar delegimin nga Bashkia e Tiranës, në Njësitë Bashkiake, të kompetencave që lidhen me administrimin e Tregjeve Publike dhe Bibliotekave në qytetin e Tiranës. Në zbatim të këtij vendimi, pozicioni “Specialist për Tregjet” është përfshirë në strukturën e Njesisë Bashkiake Nr. 5, Tiranë, në vitin 2005, sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 10, datë 21.03.2005 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë së Tiranës “Mbi disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.01.2001 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”. Sipas këtij vendimi dhe Tabelës 1 bashkëlidhur tij, strukturës ekzistuese të Njesisë Bashkiake nr. 5 i shtohet 1 vend pune për pozicionin “Specialist për Tregjet”.

Nga këqyrja e strukturës së institucionit, konstatohet se me emërtesën specialist janë përfshirë edhe funksione të tjera të deleguara në pozicione të tjera të ngjashme si “Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve”, të cilët janë trajtuar si pozicione të shërbimit civil.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se struktura organizative për administratën e institucionit të mbikëqyrur është e organizuar mbështetur në parimin e hierarkisë dhe se në përmbajtjen e saj prezantohen niveli i funksionarëve politikë, nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë. Gjithsesi, njësia përgjegjëse duhet:

- Të rishikojë strukturën dhe organikën, lidhur me klasifikimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, të përgatisë ndryshimet e strukturës të shoqëruar me relacionin përkatës ku të argumentohen shkaqet dhe arsyet për të cilat kërkohet ky ndryshim në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt. Këto veprime duhet të kryhen në koherencë edhe me implementimin e reformës territoriale që riorganizon gjithë administratën vendore.
- Të bëjë një ndarje të qartë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, ndarje kjo që duhet të jetë e pasqyruar edhe në strukturën dhe organikën përkatëse duke shënuar edhe kategorinë e pagës për çdo pozicion pune.
- Të rishikojë emërtesat e pozicioneve të punës, sipas Lidhjes 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Në këto rrethana, njësisë përgjegjëse i lind si detyrë që emërtesat e pozicioneve të punës “Jurist”, “Administrator Social”, “Ekonomist”, “Arkivist”, të ekuivalentohen me emërtesat përkatëse të pozicioneve të punës të përcaktuara në nenin 19, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për

nëpunësin civil" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", kreu II i titulluar "Klasifikimi", (pika 5) dhe kreu III i titulluar "Grupet e pozicioneve të punës" si dhe Lidhja 3 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- Në lidhje me pozicionet e punës "Specialist për tregjet" dhe "Arkivist-Protokollist", njësia përgjegjëse të rishikojë vlerësimin e pozicionit të tyre në raport me shërbimin civil, me qëllim përfshirjen në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil. Për nëpunësit e punësuar në këto pozicione pune, duhet të kryhen procedurat e verifikimit, lidhur me plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 67 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Në përfundim të verifikimit të plotësimit të kritereve të përcaktuara, rast pas rasti të vendoset deklarimi i statusit të punësimit në kategorinë "nëpunës civil", apo "nëpunës civil në periudhë prove", ose në rast se punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil, të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil.
- b) Plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Për këtë arsye, deklarimi si nëpunës civil ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, "Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë";
- pika 4, "nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji";
- pika 6, "Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit".

Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" parashikon se:

- Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", në pikën 1 përcakton se: "Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
- Kreu III "Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunitat" në pikën 1 të tij përcakton se "Punonjës ekzistues", sipas pikës 3 të nenit 67 të

ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe:

a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo

b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit".

Dispozitat e sipërpërmendura përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësimit pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Rezulton se njësia përgjegjëse ka kryer procesin e verifikimit të statusit të punësimit për 18 nëpunës të Njësisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, si më poshtë:

- në 15 raste pas verifikimit të dosjeve të personelit është deklaruar se nëpunësit gëzojnë statusin "nëpunës civil";
- në 3 raste pas verifikimit të dosjeve të personelit është deklaruar se nëpunësit gëzojnë statusin "nëpunës civil në periudhë prove".
- Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, 2 pozicione pune ishin pozicione vakante dhe për këtë arsye nuk është kryer procesi i verifikimit të statusit (1 pozicion specialist në zyrën e përkrahjes sociale dhe 1 pozicion specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve).

Pas analizës së situatës lidhur me statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton sa më poshtë:

b.1. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, është institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", tashmë i shfuqizuar. Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësve si dhe listëprezencës së muajit shkurt 2014, rezulton se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në datën 26.02.2014, punonjës të cilët u ishin nënshtruar procedurave konkurruese dhe mbanin pozicione pune të shërbimit civil, kanë qenë si më poshtë:

1. ***** - në pozicionin e punës "Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale";
2. ***** - në pozicionin e punës "Specialist në Zyrën e Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale";
3. ***** - në pozicionin e punës "Jurist";
4. ***** - në pozicionin e punës "Specialist i Informimit qytetar";
5. ***** - në pozicionin e punës "Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Ekonomike";
6. ***** - në pozicionin e punës "Ekonomist";
7. ***** - në pozicionin e punës "Inspektor taksash";
8. ***** - në pozicionin e punës "Inspektor Taksash";

9. ***** - në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës”;
10. ***** - në pozicionin e punës “Specialist infrastrukture në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës”;
11. ***** - në pozicionin e punës “Specialist urban në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës”;
12. ***** - në pozicionin e punës “Specialist mjedisi në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës”;

Në zbatim të pikës 6 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse rezultoi të ketë verifikuar statusin e punësimit për punonjësit e sipërpërmendur dhe është shprehur në aktet e verifikimit se në datën 26.02.2014, në 10 raste punonjësit gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa në 2 raste gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në periudhë prove. Më konkretisht njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e verifikimit si më poshtë:

- Akte verifikimi të statusit të punësimit me anë të të cilëve deklarohet se punonjësit gëzojnë statusin “nëpunës civil”:
 1. ***** - Akt verifikimi nr. 48 prot. datë 06.06.2014, me anë të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është shpallur kandidatë fituese në procedurën e konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe është konfirmuar nëpunëse civile me Vendimin nr. 14, datë 16.03.2010.
 2. ***** - Akt verifikimi nr. 54 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është shpallur kandidatë fituese në procedurën e konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe është konfirmuar nëpunëse civile me Vendimin nr. 15, datë 16.03.2010.
 3. ***** – Akt verifikimi statusi nr. 49 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin qershor 2011. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin “Jurist” me Vendimin nr. 15, datë 12.02.2014.
 4. ***** - Akt verifikimi nr. 52 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin tetor 2012. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin “Specialist i informimit qytetar” me Vendimin nr. 26, datë 19.02.2014.
 5. ***** - Akt verifikimi nr. 47 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin janar 2006. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike” me Vendimin nr. 28, datë 21.02.2014.
 6. ***** - Akt verifikimi nr. 53 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin gusht 2002. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin “Ekonomist në Sektorin e Burimeve Ekonomike” me Vendimin nr. 17, datë 14.02.2014.

7. ***** - Akt verifikimi nr. 55 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin nëntor 2008. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin "Inspektor Taksash" me Vendimin nr. 25, datë 18.02.2014.
8. ***** - Akt verifikimi nr. 46 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësi në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësi ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin janar 2004. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës" me Vendimin nr. 8, datë 06.02.2014.
9. ***** - Akt verifikimi nr. 50 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin tetor 2001. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin "Specialist i Infrastrukturës Urbanistike" me Vendimin nr. 10, datë 07.02.2014.
10. ***** - Akt verifikimi nr. 51 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja ka filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë në muajin shkurt 2007. Në vijim i është nënshtruar procedurës së konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" për të njëjtin pozicion pune dhe është shpallur kandidatë fituese duke u emëruar në pozicionin "Specialist urbanist" me Vendimin nr. 12, datë 10.02.2014.

Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë si institucion i qeverisjes vendore, ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil". Ky ligj përcaktonte rekrutimin nëpërmjet konkurrimit si mënyrë të vetme për plotësimin e një pozicioni pune pjesë e shërbimit civil. Pavarësisht këtij fakti, rekrutimi i punonjësve në këtë institucion nëpërmjet konkurrimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" është bërë vetëm në raste të veçanta. Emërimi i punonjësve është bërë në përgjithësi, fillimisht nëpërmjet emërimit nga titullari i institucionit dhe marrëdhënia e tyre e punës është rregulluar sipas kontratave individuale të punës, bazuar në Kodin e Punës.

Kështu, nëpunësit e çertifikuar, kanë qenë në marrëdhënie pune në Njësinë Bashkiake nr. 5, Tiranë, në vijimësi, sipas akteve përkatëse të emërimit edhe para organizimit të procedurave respektive të konkurrimit për pozicionet e punës që ata mbajnë, me përjashtim të nëpunëses ***** e cila ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, vetëm pas zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin që mban aktualisht.

Marrëdhënia e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5, Tiranë, për të gjithë nëpunësit e sipërpërmendur ka një kohëzgjatje më të madhe se një vit, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në të njëjtën kohë, përveç nëpunësve ***** dhe ***** në rastin e të cilave procedurat e konkurrimit për pozicionet që ato mbajnë, janë zhvilluar më herët në kohë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", e për pasojë këto nëpunëse janë konfirmuar si nëpunëse civile në përfundim të periudhës së provës, të gjithë rastet e tjera, i janë nënshtruar procedurës së konkurrimit dhe janë emëruar në pozicionet respektive të punës që mbanin

vetëm pak kohë para momentit të fillimit të efekteve të ligjit juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Dispozitat kalimtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 116 datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", konkretisht pikat 4 dhe 5 të Kreut IV "Dispozita Transitore" përcaktojnë se:

"4. Nëpunësit civilë, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe që janë në periudhë prove, vazhdojnë periudhën e provës sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj¹.

5. Procedura e vlerësimit në përfundim të periudhës së provës, për këta nëpunës, bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar."

Për pasojë, për nëpunësit *****, *****, *****, *****, *****, *** dhe ***** njësia përgjegjëse në aktet përkatëse të verifikimit të statusit, duke marrë parasysh faktin se emërimi i tyre përfundimtar ishte bërë në muajin shkurt 2014, pas procedurave të konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhej të kishte deklaruar statusin e punësimit si nëpunës civil në periudhë prove.

Megjithatë, konstatohet se pavarësisht nga deklarimi fillestar i statusit të nëpunës civil, nëpunësit që do të përmendim në vijim, janë konfirmuar si nëpunës civil pas një periudhe një vjeçare, gjatë të cilës kanë ndjekur dhe janë vlerësuar për ciklin e trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP), në përputhje me pikën 5, Kreu IV, të aktit nënligjor të përmendur më sipër. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 875 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Jurist";
2. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 882 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Specialist i informimit qytetar";
3. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 874 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike";
4. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 879 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Ekonomist në Sektorin e Burimeve Ekonomike";
5. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 880 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Inspektor Taksash në Sektorin e Burimeve Ekonomike";
6. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 873 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës";
7. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 878 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës";
8. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 877 prot. datë 20.04.2015 në pozicionin "Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës".

¹ Ligji nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", nen 14, pika 1, përcakton se nëpunësi civil i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

- Akte verifikimi të statusit të punësimit me anë të të cilëve deklarohet se punonjësit gëzojnë statusin "nëpunës civil në periudhë prove":

1. ***** - Akt verifikimi nr. 63 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësjë në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil në periudhë prove. Nëpunësjë është shpallur kandidatë fituese në procedurën e konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe është emëruar pozicionin "Inspektor Taksash" me Vendimin nr. 24, datë 18.02.2014.
2. ***** - Akt verifikimi nr. 62 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësi në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil në periudhë prove. Nëpunësi është shpallur kandidat fitues në procedurën e konkurrimit sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe është emëruar në pozicionin "Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës" me Vendimin nr. 33, datë 25.02.2014.

Nga këqyrja e dokumentacionit përkatës, u konstatua se dy nëpunësit e sipërpërmendur kanë filluar marrëdhënien e punës në Njësinë Bashkiake nr. 5 Tiranë, bazuar në aktet përkatëse të emërimit, pas zhvillimit të procedurës së konkurrimit, përkatësisht në datat 18.02.2014 dhe 24.02.2014. Gjatë procesit të verifikimit të statusit njësjë përgjegjësjë në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 116 datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësjë aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ka konsideruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

Nëpunësit në fjalë, në përputhje me pikën 5, Kreu IV të aktit nënligjor të përmendur më sipër, kanë ndjekur dhe janë vlerësuar për ciklin e trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe në përfundim janë konfirmuar si nëpunës civil, si më poshtë:

1. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar nr. 877 prot., datë 20.04.2015, në pozicionin "Inspektor Taksash në Sektorin e Burimeve Ekonomike".
2. ***** - Akti i deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar, nr. 877 prot., datë 20.04.2015 në pozicionin "Specialist në Sektorin e Shërbimit Urban dhe Infrastrukturës".

Aktet që materializojnë procedurën e konkurrimit janë të evidentuara në aneksin që i bashkëlidhet këtij raporti i emërtuar - **Aneks nr. 3** "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të cilët ishin punësuar nëpërmjet konkurrimit".

Konkluzion: Njësjë përgjegjësjë ka ndërmarrë procedurën e verifikimit dhe deklarimit të statusit brenda afateve kohore të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 116, datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësjë aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".

Veprimet e njësjë përgjegjësjë për të formalizuar dhe deklaruar statusin e punësimit si "nëpunës civil" për nëpunëset ***** dhe ***** dhe si "nëpunës civil në periudhë prove" për nëpunësit ***** dhe ***** janë në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.116, datë 05.03.2014, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësjë aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Aktet përkatëse të verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit, konstatohen të jenë të paplotë, pasi në përmbajtjen e tyre nuk është referuar pozicioni përkatës i punës për të cilën deklarohet statusi i punësimit nëpunës civil, apo sipas rastit, nëpunës civil në periudhë prove.

Për pasojë rekomandohet njësia përgjegjëse të bëjë plotësimin e akteve përkatëse të deklarimit të statusit të punësimit, duke referuar saktë pozicionin përkatës të punës për nëpunësit ***** dhe ***. Për nëpunësit ***** dhe ***** njësia përgjegjëse, pas një periudhe kohore njëvjeçare, që korrespondon me periudhën e provës nga data e aktit të emërimit, gjatë të cilës kanë ndjekur ciklin e trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe janë vlerësuar, rezulton se e ka rregulluar situatën, duke realizuar konfirmimin e tyre si nëpunës civilë, si dhe duke e materializuar këtë proces, në aktet përkatëse të deklarimit të statusit nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin përkatës.

Njësia përgjegjëse, gjatë deklarimit fillestar të statusit të punësimit për nëpunësit ***** , *** **, ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** si nëpunës civil, nuk ka marrë parasysh aktet e emërimit të tyre në shërbimin civil, si më sipër përmendur, pas realizimit të procedurave të konkurrimit, sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", nenit 24 dhe 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe dispozitat kalimtare të Vendimit nr. 116 datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, këta nëpunës, duhet të ishin deklaruar nëpunës civilë në periudhë prove, duke vazhduar periudhën e provës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Gjithsesi, njësia përgjegjëse, ka marrë masat për rregullimin e situatës dhe gjatë periudhës kohore njëvjeçare që korrespondon me periudhën e provës nga data e aktit të emërimit, ka marrë masat që nëpunësit në fjalë të ndjekin ciklin e trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe të vlerësohen, e në përfundim të kësaj periudhe, ka kryer konfirmimin e tyre si nëpunës civilë, duke materializuar këtë proces në aktet përkatëse të deklarimit të statusit nëpunës civil i konfirmuar, si më lart përmendur.

b.2 Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të këqyruar dhe administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se në këtë institucion në momentin e shtrirjes së efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (1) një punonjës është emëruar me akt emërimi të përkohshëm në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, duke mos respektuar procedurat e pranimit në shërbimin civil, si dhe procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sikurse përcaktohej në nenin 13 e vijues të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Ndonëse dispozitat ligjore në fjalë përcaktonin procedurat e pranimit në shërbimin civil dhe të lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, marrëdhënia e punës për këtë punonjës është rregulluar sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësin ***** , i cili ka filluar marrëdhënien e punës pranë Njesisë Bashkiake, me Urdhrin nr. 30 datë 26.02.2014 "Për lidhje kontrate provizore pune", në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore", ndërkohë që marrëdhënia financiare ka filluar me datë 25.02.2014. Me aktin nr. 61 prot. datë 06.06.2014 "Verifikim Statusi" është deklaruar nëpunës civil në periudhë prove me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Gjatë periudhës së provës ka ndjekur dhe është

vlerësuar për ciklin e detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe me aktin nr. 883 prot. datë 20.04.2015 është deklaruar nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore"*.

Konkluzion: Procedura e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësin ***** është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 05.03.2014, *"Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"*.

Në të njëjtën kohë, konstatohet se akti përkatës i verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit, rezultoi i paplotë në drejtim të referimit në përmbajtje të tyre të pozicionit përkatës të punës për të cilin deklarohet statusi i punësimit nëpunës civil në periudhë prove, ç'ka është rregulluar me aktin nr. 883 prot. datë 20.04.2015, me anë të të cilit është deklaruar nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore"*.

b.3. Pozicione pune që përfshihen për herë të parë në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Sikurse parashtruam në hyrje të këtij raporti, në strukturën e Njesisë Bashkiake nr. 5, Tiranë, përfshihet edhe Zyra e Gjendjes Civile, e cila duhet të përfshihet në skemën e shërbimit civil. Duke analizuar aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj strukture, rezultoi se shërbimi i gjendjes civile, në kuptim të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 *"Për gjendjen civile"*, ushtrohet si funksion i deleguar në organet e qeverisjes vendore. Sipas nenit 61 të këtij ligji, gërma "c", shërbimi i gjendjes civile, funksionon edhe në njësitë bashkiake, i organizuar si Zyra të Gjendjes Civile.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile në Njësitë Bashkiake, deri në datën 26.02.2014, janë rregulluar sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*. Pas ndryshimeve ligjore të fundit dhe si pasojë e zgjerimit të fushës së shërbimit civil, në skemën e shërbimit civil duhet të përfshiheshin edhe Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Bashkiake, pasi, në nenin 2 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, është parashikuar në mënyrë të shprehur se fusha e veprimit të tij, shtrihet dhe përfshin çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Më tej, në nenin 65 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 *"Për gjendjen civile"*, përcaktohet se rekrutimi i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave konkurruese të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, i cili, është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile dhe një institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549/1999 *"Statusi i nëpunësit civil"*. Pra, duke pasur parasysh faktin që emërimi i punonjësve të shërbimit të gjendjes civile kryhet mbi bazën e një procedure konkurruese të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549/1999 *"Statusi i nëpunësit civil"*, si dhe përfshirjen e këtyre pozicioneve në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1299, datë 16.12.2009 *"Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve"*, Zyra e Gjendjes Civile, në institucionin e mbikëqyrur, përbëhet nga 5 pozicione pune. Nga këqyrja e dokumentacionit përkatës rezultoi se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, por edhe në periudhën e realizimit të

mbikëqyrjes, në Zyrën e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake nr. 5, Tiranë janë të punësuar këta punonjës:

- ***** , *Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile;*
- ***** , *Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;*
- ***** , *Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;*
- ***** , *Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;*
- ***** , *Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile.*

Aktet rregulative të shërbimit të gjendjes civile, përcaktojnë se shërbimi i gjendjes civile ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile, përcaktohet me akt nënligjor nga Këshilli i Ministrave. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile, realizon drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile.

Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, realizohet nga kryetari i njesisë bashkiake, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, është kompetencë e kryetarit të njesisë bashkiake, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, konkretisht në nenin 7, pika 2, shkronja “f”, përcaktohet se një nga detyrat e Departamentit të Administratës Publike, është të *“mbështesë dhe sigurojë këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji”*. Në këto rrethana, institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (*që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile*) dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (*sekretari i përgjithshëm është organi që vjen menjëherë si epror i Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile*) dhe Departamentin e Administratës Publike, duhet të qartësonin pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil dhe të vijonin përkatësisht me procedurën e verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit.

Nga dokumentacioni i administruar në dosjet personale të punonjësve rezulton se njësia përgjegjëse fillimisht ka ndërmarrë procesin e verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit si më poshtë:

1. ***** - Akt verifikimi nr. 56 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është emëruar në pozicionin *“Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”* me Urdhrin nr. 44 datë 01.12.2010.
2. ***** - Akt verifikimi nr. 60 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është emëruar në pozicionin *“Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”* me Urdhrin nr. 36 datë 20.10.2006.
3. ***** - Akt verifikimi nr. 58 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është emëruar në pozicionin *“Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”* me Urdhrin nr. 26 datë 30.06.2010.
4. ***** - Akt verifikimi nr. 59 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është emëruar në pozicionin *“Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”* me Urdhrin nr. 30 datë 19.07.2010.
5. ***** - Akt verifikimi nr. 59 prot. datë 06.06.2014, me anë të të cilit deklarohet se punonjësja në fjalë gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësja është emëruar në pozicionin *“Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”* me Urdhrin nr. 53 datë 21.10.2010.

Por në vijim, për shkak të paqartësive të ndeshura nga njësia përgjegjëse në lidhje me trajtimin e këtyre pozicioneve të punës sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, institucioni i mbikëqyrur ka ndryshuar qëndrim duke konsideruar se këto pozicione pune nuk përfshihen në shërbimin civil.

Për të gjithë këta punonjës, që momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, i ka gjetur si punonjës të Zyrës së Gjendjes Civile, në pozicionet përkatëse të punës, njësia përgjegjëse, duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile) dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (sekretari i përgjithshëm është organi që vjen menjëherë si epror i Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile,) si dhe Departamentin e Administratës Publike, për të qartësuar pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil.

Konkluzion: Nga sa analizuar më sipër, Komisioneri vlerëson se procedura e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësin ***** , ***** , ***** , ***** , ***** duhet të qartësohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile); Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (sekretari i përgjithshëm është organi që vjen menjëherë si epror i Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile) dhe Departamentin e Administratës Publike.

II. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.

Një aspekt shumë i rëndësishëm, i cili ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, të tillë si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe Udhëzimi i Departamentit të Administratës Publike nr. 2, datë 07.04.2014 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil", si akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, kanë përcaktuar qartë dhe me hollësi procedurat për hartimin e përshkrimit të punës, për çdo pozicion pune që përfshihet në shërbimin civil.

Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit respektiv të punës, zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen, mjedisin menaxherial, mbikëqyrjen, stafin në varësi (në rastet kur ka), kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës. Gjithashtu, kërkohet që rolet dhe aktorët që marrin pjesë në këtë proces, të jenë të përcaktuar qartë duke sjellë efikasitet në mënyrën e funksionimit të këtij procesi në tërësi, me qëllim realizimin e misionit të institucionit nga pikëpamja e metodologjisë së klasifikimit të një pozicioni në një kategori, klasë dhe grup të caktuar.

Nga verifikimi u konstatua se në subjektin e mbikëqyrur nuk janë hartuar përshkrimet e punës për asnjë nga pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil (përfshirë këtu dhe pozicionet e punës në Zyrën e Gjendjes Civile), duke përdorur formatin standard të miratuar me Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" (Lidhja 4 bashkëlidhur këtij vendimi).

Konkluzion: Në këto rrethana, duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që paraqet përshkrimi i punës për çdo pozicion pune të shërbimit civil, në drejtim të kontrollit të aktivitetit të nëpunësit, si

dhe vlerësimi të punës në fund të vitit kalendarik, por edhe si një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, rekomandohet që njësia përgjegjëse në bashkëpunim me eprorët direkt, për pozicionet përkatëse, në koherencë me ndryshimet organizative për shkak të reformës territoriale, të marrë masat të hartojë menjëherë përshkrimet e punës për çdo pozicion pune pjesë të shërbimit civil.

Ky proces duhet të ketë si bazë modelin e miratuar në lidhjen 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil", duke marrë masat që formularët të jenë të saktë dhe të plotë në përmbajtje dhe në formë dhe të nënshkruhen nga eprori direkt i nëpunësit civil, nga ky i fundit, si dhe nga titullari i institucionit.

III. Vlerësimi i rezultateve në punë

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili i shërben verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Vlerësimi i rezultateve në punë shërben gjithashtu si një element i rëndësishëm për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirin nga shërbimi civil, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Nisur nga përmbajtja e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109 datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", akt i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, rezulton se në të janë përcaktuar me hollësi procedura dhe kompetenca për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjektin e mbikëqyrur rezulton se formulari që përdoret në këtë institucion për vlerësimin e rezultateve në punë për pozicionet e punës që janë konsideruar pjesë e shërbimit civil është hartuar sipas formatit të miratuar sipas Lidhjes 2 të Vendimit nr. 109 datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë".

Konstatohet se në përmbajtjen e këtij akti janë përfshirë të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); konteksti i punës për objektivat e institucionit dhe njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke pasur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektivi specifik dhe të matshëm (ndarja C); sjellja profesionale, që ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer, realizimi në kohë, kolegjaliteti i marrëdhënieve dhe gatishmëria për punën në grup, shpeshësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesat për këshillim, trajnimi dhe ngritja profesionale (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet vlerësimi i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes u konstatua se në institucionin e mbikëqyrur janë kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014 për nëpunësit civil, të cilët mbajnë pozicione pune të nivelit të ulët drejtues dhe pozicione të nivelit ekzekutiv.

Vlerësimet e rezultateve në punë janë bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 109 datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil".

Formulari standard i miratuar, vërehet të jetë plotësuar në rubrikat përkatëse dhe është nënshkruar nga secili nëpunës i përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë. Nga këqyrja e dokumentacionit nuk konstatohen raste të mosmarrëveshjeve midis "Zyrtarit Autorizues" dhe/ose "Zyrtarit Kundërfimues dhe Zyrtarit Autorizues" në lidhje me nivelin e vlerësimit, apo raste të rivlerësimit nga zyrtari autorizues (ndarja DH), për shkak të pretendimeve në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë.

Kështu nga pikëpamja formale ky proces konstatohet i rregullt, por në analizë të përmbajtjes së procesit, vihet re se vlerësimi i rezultateve në punë është në nivelin 2 "Mirë", ç'ka do të thotë se procesi karakterizohet nga vlerësimi në një nivel të lartë për të gjithë punonjësit. Kjo mënyrë vlerësimi që përqendrohet kryesisht në nivelet e larta të vlerësimit, duke anashkaluar tërësisht nivelet e tjera të vlerësimit, nivelin 3 "Kënaqshëm" dhe nivelin 4 "Jo mjaftueshëm", të krijojnë përshtypjen se procesi i vlerësimit cedon në drejtim të objektivitetit dhe njëkohësisht, krijojnë mundësinë e humbjes së interesit dhe motivimit të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie, në kushtet kur konstatohet se vlerësimin "mirë" e marrin pa dallim pothuajse gjithë nëpunësit civilë të institucionit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson punën e bërë nga njësi përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit pjesë e shërbimit civil. Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë (sipas modelit të miratuar) për secilin punonjës administrohet në dosjet individuale të tyre dhe është plotësuar në mënyrë të plotë dhe korrekte nga aktorët pjesëmarrës në procesin e vlerësimit. Në kushtet kur procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit civil, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre, njësi përgjegjëse duhet në vazhdimësi të tregojë kujdes që ky proces të mos trajtohet si një procedurë formale, por si një proces që analizon me seriozitet dhe vlerëson me objektivitet gjithë aspektet e përfshira në rubrikat e ndryshme të formularit të vlerësimit, duke stimuluar përdorimin e të gjitha niveleve të vlerësimit të punës, të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore.

IV. Procedura e ndjekur nga institucioni për miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil

Administrimi i shërbimit civil mbështetet në planin vjetor të pranimi, i cili sikurse përcaktohet shprehimisht në nenin 18 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, miratohet dhe publikohet jo më vonë se muaji shkurt i vitit përkatës kalendarik. Në zbatim të kësaj dispozite, Vendimi nr. 108 datë 26.02.2014 i Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil", ka përcaktuar rregullat dhe procedurat e hollësishme për miratimin e planit të pranimi në shërbimin civil.

Sikurse përcaktohet në këto dispozita, plani i pranimi në shërbimin civil për njësitë e qeverisjes vendore, duhet të miratohet dhe publikohet brenda muajit shkurt të vitit kalendarik, të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 2 të Vendimit nr. 108 datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil", duke mbajtur në konsideratë mundësinë e krijimit të vendeve vakante për shkak të ligjit, krijimit të vendeve të reja të punës, apo sipas rastit dhe arsye të tjera.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se institucioni objekt i mbikëqyrjes nuk ka marrë masat për miratimin dhe publikimin e planit vjetor të pranimi në përmbushje të detyrimit ligjor si më sipër parashtruar.

Konkluzion: Në këto kushte, duke pasur parasysh parashikimet e nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", si dhe ndryshimet në riorganizimin e njësive bashkiake, në bashkinë Tiranë, në të ardhmen njësia përgjegjëse duhet të përfshijë në planin e rekrutimit edhe administratën e njësive bashkiake, tashmë njësi administrative dhe të publikojë brenda afateve ligjore, planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, duke marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në dispozitat e sipërpërmendura.

V. Rastet e rekrutimeve, transferimit të përkohshëm apo të përhershëm, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në datën 26 shkurt 2014, pra në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, 2 pozicione të shërbimit civil, kanë qenë vakante dhe janë plotësuar në vijim:

- "Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve" dhe
- "Administrator Social"

Aktualisht, në këto pozicione pune janë emëruar përkatësisht:

- ***** , në pozicionin "Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve", emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 164, datë 23.01.2015 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, në vijim të Urdhrit nr. 660, datë 15.01.2015 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.
- ***** , në pozicionin "Specialist i ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale (Administrator Social)", emëruar provizorisht me aktin nr. 66/1 prot. datë 10.06.2014, deri në realizimin e procedurave konkurruese për këtë pozicion.

Këto emërimet në nivelin ekzekutiv nuk janë realizuar në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese"². Konkretisht:

1. Punonjësja ***** është emëruar në pozicionin "Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve" me aktin nr. 164, datë 23.01.2015 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, dhe Urdhrit nr. 660 datë 15.10³.2015 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Konstatohet se pavarësisht faktit që ky pozicion pune është pjesë e shërbimit civil, akti përkatës i emërimit nxjerrë nga institucioni i mbikëqyrur ka për bazë ligjore, midis të tjerash, Kodin e Punës dhe jo ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Gjithashtu, u konstatua se në Urdhrit nr. 660, datë 15.01.2015 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, "Për emërim në detyrë", përcaktohet se emërimi i kësaj punonjëseje bëhet deri në përfundim të procedurave të konkursit për këtë pozicion. Nga shpjegimet e dhëna nga institucioni i mbikëqyrur se rekrutimi i kësaj punonjëseje është bërë në vijim të procedurës së konkurrimit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion për grupin e mbikëqyrjes rezultoi se:

² Shfuqizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, emërimin dhe periudhën e provës në kategorinë ekzekutive"

³ Gabim material në referencën e aktit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Urdhër nr. 660, datë 15.01.2015 "Për emërim në detyrë"

- Procedura e konkurrimit për pozicionin *"Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve"*, nuk rezultoi të jetë shpallur në portalin *"Shërbimi Kombëtar i Punësimit"*, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu II, pika 2 dhe pikat nga 5 deri në 10;
- Në institucionin e mbikëqyrur nuk rezultoi të jetë krijuar Komiteti i Përhershëm i Pranimit sipas përcaktimeve të Kreut III të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, por njësisë përgjegjëse pretendoi se me Urdhrin nr 102, datë 22.12.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë është ngritur grupi i shqyrtimit të rezultateve të konkursit që do të zhvillohej në datë 26.12.2014.
- Procesi i verifikimit paraprak, i cili ka për qëllim të sqarojë nëse kandidatët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pikat 1 dhe 3, nuk rezultoi të jetë realizuar dhe po kështu edhe shpallja e fituesve;
- Komisioni i vlerësimit të përgjigjeve të konkursit me shkresën e datës 26.12.2014 *"Njoftim"* i ka komunikuar titullarit të institucionit vlerësimin për kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë konkurrimi duke vlerësuar si më poshtë:
 - kandidatja ***** është vlerësuar me shumën totale 75 (shtatëdhjetë e pesë) pikë
 - kandidatja ***** është vlerësuar me shumën totale 65 (gjashtëdhjetë e pesë) pikë
 - kandidatja ***** është vlerësuar me shumën totale 56 (pesëdhjetë e gjashtë) pikë
- Në vijim, Kryetari i Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, bazuar midis të tjerash dhe në Urdhrin nr. 660 datë 15.01.2015 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, me aktin nr. 164, datë 23.01.2015 *"Për emërim në detyrë"* ka emëruar ***** në pozicionin *"Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve"*.

Nga verifikimet rezultoi se me Vendimin nr. 23, datë 09.04.2013 të Këshillit Bashkiak Tiranë *"Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 17, datë 28.02.2013 mbi "Politikën e decentralizimit të disa kompetencave ligjore pranë organeve të njësive bashkiake të Tiranë ..."*, është vendosur që në strukturën dhe organikën e njësive bashkiake të shtohet një Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar që emërimi i këtij punonjësi bëhet nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës. Mbështetur në këtë vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë, titullari i Bashkisë së Tiranës ka nxjerrë Urdhrin nr. 660, datë 15.01.2015 për emërimin e ***** në pozicionin e *"Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve"* në Njësine Bashkiake nr. 5, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit. Pozicioni i punës *"Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve"*, është pjesë e organikës së miratuar të institucionit dhe përfshihet në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil. Njësia përgjegjëse, në kushtet e ekzistencës së një pozicioni pune të shërbimit civil, duhet të kishte respektuar procedurat e konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar.

Ndërkohë rezultoi se, vendimmarja e Këshillit Bashkiak të Tiranës, për emërimin e punonjësve që do të ofrojnë shërbimin për mbrojtjen e fëmijëve, do të bëhet nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe për pasojë edhe vetë urdhri i titullarit të bashkisë, që ka emëruar punonjësin në pozicionin *"Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve"*, janë të pambështetur, si në ligjin specifik që rregullon kompetencat e njësive të qeverisjes vendore, ashtu edhe në legjisllacionin e shërbimit civil. Ligji nr. 8654, datë 31.07.2000 *"Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës"*, në nenin 9, shkronja *"dh"* përcakton se, Kryetari i njesisë bashkiake *"Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së vet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj."* Ligji nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në kreun 4 përcakton se, pranimit në

shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe më tej, neni 23, pika 4, përcakton se, "çdo emërim në pozicionin ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm". Për këtë arsye, urdhri i titullarit të bashkisë, që ka emëruar punonjësin në pozicionin "Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve", ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi kryerja e konkurrimit përbën një proces të detyrueshëm për emërimin e nëpunësve në pozicione të shërbimit civil në nivelin ekzekutiv dhe duhet të zhvillohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit për shërbimin civil.

2. Punonjësi ***** është emëruar në pozicion pune të shërbimit civil, me aktin e emërimit të përkohshëm nr. 66/1 prot. datë 10.06.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 5, Tiranë, në pozicionin "Administrator Social" dhe vazhdon të kryejë këtë funksion edhe në momentin e realizimit të mbikëqyrjes. Bazuar në aktin e emërimit të sipër cituar, marrëdhënia e punës rregullohet nga kontrata individuale e punës (provizore) ku përcaktohet se afati i saj mbaron në momentin që do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për pozicionin e punës "Administrator Social" sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Akti i sipërpërmendur ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore. Çdo emërim në pozicionin ekzekutiv që bëhet në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 23 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, është absolutisht i pavlefshëm.

Konkluzion: Në këto rrethana, në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, Urdhri nr. 164, date 23.01.2015 i Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, Urdhri nr. 660 datë 15.01.2015 i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve" në Njesisë Bashkiake nr. 5 Tiranë, si dhe Urdhri nr. 66/1 prot., datë 10.06.2014, të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 5, Tiranë, për emërimin e përkohshëm të ***** në pozicionin "Administrator Social", të evidentuar më sipër, janë akte absolutisht të pavlefshëm, pasi janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe me procedurën e kërkuar nga ligji nr.152.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Këto pozicione duhet të konsiderohen si pozicione të lira dhe duhet të plotësohen nëpërmjet procedurave ligjore, sipas rastit, konkurrim apo lëvizje paralele, në përputhje me parashikimet e nenit 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

VI. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes, apo për shkak të ligjit

Nga këqyrja e strukturës analitike dhe listëprezencës e listëpagesës së muajit shkurt 2014, si dhe listëprezencës e listëpagesës në momentin e mbikëqyrjes, si dhe dokumentacionit për shkëputjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare për punonjësit ***** (për shkak dorëheqjeje), ***** (për shkak të plotësimit të moshës për pension) dhe ***** (për shkak dorëheqjeje), rezultoi se pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (pas datës 26.02.2014) nuk ka patur raste lirimi nga detyra në pozicione të shërbimit civil.

Në të tre rastet e sipërpërmendur shkëputja e marrëdhënieve të punës është bërë para datës 26.02.2014.

VII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përfshirë në dosjet individuale të personelit, por edhe nga sqarimet dhe deklaratimet e drejtuesit të Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, pasqyruar në procesverbalin administrativ të datës 05.06.2015, të mbajtur midis grupit të mbikëqyrjes dhe përfaqësuesit të subjektit, rezultoi se pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nuk ka pasur dhe nuk janë zhvilluar procedura disiplinore për nëpunësit që mbajnë pozicione pune pjesë të shërbimit civil.

Konstatohet se nuk është ngritur Komisioni Disiplinor i parashikuar nga neni 59 i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 115 datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil, me pretendimin se nuk ka pasur kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore.

Ndërkohë, referuar përsëri përmbajtjes së dispozitave që kemi cituar në paragrafin më sipër, të cilat rregullojnë përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës, tashmë ky mekanizëm është një komision i përhershëm, i cili duhet të ngrihet që në fillim të vitit kalendarik dhe duhet të jetë funksional përgjatë gjithë vitit.

Në këto rrethana, rekomandojmë njësinë përgjegjëse që të kujdeset për të ngritur menjëherë Komisionin Disiplinor, duke respektuar përcaktimet për përbërjen e këtij komisioni në përputhje me parashikimet ligjore të sipërpërmendura.

VIII. Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaratimit të statusit të punësimit nga njësinë përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit dhe akte të tjera që kanë të bëjnë me deklaratimin e statusit të punësimit.

Sikurse u parashtua më sipër, grupi i punës, verifikoi dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (fotokopje e letërnjoftimit); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokumentet që vërtetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (akti i emërimit); dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore; dokumenti që vërteton se nëpunësi është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse, etj.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar për secilin nëpunës në aneksin që i bashkëlidhet raportit, si pjesë e tij.

Të gjitha aktet e emërimit që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike lëvizjet e nëpunësit nga momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare e në vijim (*aktet që pasqyrojnë emërimin në pozicionin e punës, kontratat individuale të punës, ndryshime që lidhen me pozicionin e punës*) janë të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi.

Po kështu dhe vlerësimet e punës të plotësuara në mënyrën e duhur dhe të nënshkruara nga nëpunësit/strukturat kompetente janë të administruara në dosjen individuale të nëpunësit civil.

Konstatohet se dosjet individuale të nëpunësve janë të sistemuara mirë, ruhen në kushte të përshtatshme dhe administrohen bashkë me librezat e punës për secilin punonjës nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, që është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me pikën 4 të Kreut I, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*".

Sikurse më sipër u parashtrua, duke qenë se njësia përgjegjëse nuk ka hartuar përkrahjet e punës për secilin pozicion pune të shërbimit civil, grupi i mbikëqyrjes konstatoi mungesën e tyre në dosjet individuale të punonjësve.

Konkluzion: Komisioneri konkludon se:

- Dosjet e personelit në përmbajtjen e tyre i kanë të përfshira dokumentet me të dhënat e kërkuara nga Vendimi nr. 117, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit të personelit*" dhe lidhjet 1 e 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- Dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore.
- Njësia përgjegjëse, pas hartimit të përkrahjeve të punës për secilin pozicion pune duhet të marrë masat të përfshijë në dosjet përkatëse të secilit nëpunës përkrahimin e punës.

IX. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse) gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Administrimi i shërbimit civil, është një proces i rëndësishëm, i cili duhet të realizohet duke u drejtuar nga ligji, për të siguruar respektimin e parimeve të këtij procesi, që synojnë në vendosjen e palëve përballë shanseve të barabarta, zhvillimin e një karriere të bazuar në meritë, mos diskriminimin e palëve në proceset e administrimit, profesionalizmit të administratës, sigurimin e transparencës dhe paanësisë politike, si dhe të garantohet qëndrueshmëria në detyrë e nëpunësit civil dhe vazhdimësia në shërbimin civil.

Ndonëse efektet e ligjit për nëpunësin civil kanë filluar prej më shumë se një viti, nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Njësisë Bashkiake nr. 5, Tiranë, konstatohet një harmonizim vetëm pjesërisht me parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Pavarësisht faktit që korniza ligjore e cila rregullon fushën e shërbimit civil është plotësuar, duke përcaktuar me qartësi kushtet dhe hapat që duhet të ndërmarrin institucionet shtetërore që i nënshtrohen fushës së zbatimit të tij, përsëri vërehet zbatim jo i plotë i ligjit nga ana e institucionit të mbikëqyrur.

Në këtë kontekst konstatohet se, ndonëse janë bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, në disa raste nuk janë respektuar e përmbushur plotësisht normat dhe standardet e kërkuara. Konstatohet se në disa raste, nga ana e institucionit është bërë një interpretim jo i saktë i ligjit nr. 152/2103 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Këto mangësi u konstatuan në drejtim të hartimit të përshkrimeve të punës, miratimit të planit vjetor të pranimin në shërbimin civil, emërimit në pozicione të shërbimit civil të nivelit ekzekutiv pa ndjekur procedurën e konkurrimit apo trajtimit që i bëhet pozicioneve të caktuara si jo pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga rrethanat e reja në të cilat do të vijojë administrimi i shërbimit civil në institucionet e administratës vendore, në kuadër të riorganizimit të pushtetit vendor, del si domosdoshmëri që subjekti të ketë identifikuar saktë nëpunësit, të cilët përfitojnë nga ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, pasi ata gëzojnë të gjitha të drejtat e sanksionuara në këtë ligj.

*
* * *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në Njësinë Bashkiake nr. 5, Tiranë, në lidhje me monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij. Sjellim dhe një herë në vëmendje të njësisë përgjegjëse, se të gjitha rekomandimet e paraqitura në këtë raport, duhet të zbatohen në koherencë të plotë me aplikimin e reformës territoriale, e cila riorganizon të gjitha njësitë bashkiake të Bashkisë së Tiranës.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

- *Aneksi 1 "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)".*
- *Aneksi 2 "Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 5, Tiranë".*
- *Aneksi 3 "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të cilët ishin punësuar nëpërmjet konkurrimit (data 26.02.2014)".*
- *Historiku i marrëdhënies së punës për punonjësit në Njësinë Bashkiake nr.5, Tiranë.*

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA